



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 66/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bujar Dobërdolani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K.S., me seli në P.1, rr.“F.G.”, nr..., kundër të paditurit G.I.K., nga fshati M., Komuna e P.2, lidhur me çështjen juridike rimbursim dëmi, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, në prani të të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, me dt. 11.10.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditëses B.K.S. me seli në P.1 si e bazuar dhe DETYROHET i padituri G.I.K., nga P.1 i që paditëses t’ia kompensoi shumën prej 1,059.00€, në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e trafikut me dt. 17.07.2011 në fshatin Ll., Komuna e P.2, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat vendore pa destinim të caktuar me tepër se një vit dhe atë nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcimin të përmbarimit me dhunë.
- II. DETYROHET i padituri, që në emër të shpenzimeve procedurale, paditëses të ia paguaj shumën prej 20.00€, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësja B.K.S. me seli në P.1, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për rimbursimin e dëmit kundër të paditurit G.K., nga P., me të cilën ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurin që paditëses të ia kompensoi shumën prej 1,059.00 € në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut me dt. 17.07.2011 në fshatin Ll. dhe atë shumën prej 1,059.00€ si rimbursim, për dëmin material që i është shkaktuar, e me pas kompensuar të dëmtuarve Familja S. nga fshati B.. Paditësja kërkesën për kompenzim dëmi e ka mbështetur në marrëveshjet jashtëgjyqësoretë lidhura me palët të dëmtuaranë aksidentin e datës në fjalë, ku me datë 10.10.2011, ka lidhur Ujdi Jashtëgjyqësore me V.S., F.S. dhe Z.S. nga fshati B., për kompenzimin e dëmit material dhe jo material të pësuar në aksidentin e datës 17.07.2011.

Paditësja po ashtu ka kërkuar edhe kompenzimin e shpenzimeve procedurale.

I padituri me përgjigje në padi, fillimisht ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë, duke theksuar se nuk ka asnjë detyrim ndaj askujt për ndonjë dëme të shkaktuar, po ashtu ka theksuar se në aksidentin e ndodhur me datë 17.07.2011 ku kam qenë pjesëmarrës si vozitës i automjetit VW Passat, nuk kam qenë unë fajtor, por fajtor kanë qenë vozitësit e automjetit B dhe C. duke shtuar se paditësja kompenzimin e dëmit ndaj pjesëmarrësit tjetër në komunikacion e ka bërë me

mirëbesim pa vërtetuar saktë se si ka qenë gjendja faktike e ndodhjes së aksidentit. Ndërkohë në seancën e datës 11.09.2018, dolën në pah fakte nga e paditura, sipas të cilave i padituri lidhur me dëme tjera të shkaktuara në këtë aksident veq se ka pranuar përgjegjësin duke lidhur ujdi gjyqësore me paditësen për rimbursim, fakt ky që nuk u kontestua nga i padituri.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të të paditurit, pasi i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar më datë 11.10.2018, çka vërtetohet në bazë të procesverbalit të seancës së datës 11.09.2018, në të cilën u caktua seanca e radhës, e ku i padituri prezent u njoftua, andaj konform nenit 423.4, gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të të paditurit.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje dhe kujdesshëm të provave e në mbështetje të nenit 8 të LPK-së vërtetoi se kërkesë-padia e paditëses është e bazuar dhe si të tillë e miratohet në tërësi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen kontestuese, gjykata në shqyrtimin kryesor publik si prova administroi Raportin e Policisë nr.2011-AF-0694, dt.17.07.2011, Kërkesa për Dëmshpërblim me dt.27.07.2011, Vendimi nr.GFK,nr.1195/2011, dt.10.10.2011, Ujdia Jashtëgjyqësore me nr. 1195/11, dt. 10.10.2011 si dhe Urdhër Transferi nr.1195\11 dt.11.10.2011.

Gjykata konstaton se kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse i padituri është përgjegjës për rimbursimin e dëmit të kompozuar ndaj palëve të dëmtuar në aksidentin e komunikacionit të datës 17.07.2011.

Nga provat e prezantuar, Raporti i Policisë nr., 2011-AF-0694 dt. 17.07.2011, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se më datën 17.07.2011, rreth orës 16:00 paditësi, në fshatin Ll., i padituri si drejtues i automjetit të markës “VW Passat”, me targa të regjistrimit ..., ka shkaktuar aksident trafikës në P.1, me ç ‘rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafikës ka goditur automjetin e markës “Audi” me targa ..., pronë e Z.S., e ky automjet nga inercioni e ka goditur automjetin e markës “Suzuki”, me targa ..., pronë e E.H., me ç ‘rast janë shkaktuar dëme materiale në automjete dhe lëndime trupore pasagjereve të automjetit B dhe C si dhe drejtuesve të tyre. Automjeti A me të cilin është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, i drejtuar nga i padituri ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afat i periudhës së sigurimit.

Nga Vendimi nr. GFK,nr.1195/2011, dt. 10.10.2010, vërtetohet fakti se paditësja ka trajtuar kërkesën e të dëmtuarve Familjes S. dhe ka aprovuar kërkesën e tyre.

Nga Ujdia Jashtëgjyqësore me nr. 1195/11, dt. 10.10.2010, e lidhur në mes të paditëses dhe të dëmtuarve në aksidentin e datës 17.07.2011, V.S., F.S. dhe Z.S., vërtetohet fakti se paditësja në procedurë jashtëgjyqësore ka arritur marrëveshje me të dëmtuarit e lartcekur për kompenzimin e dëmit material dhe jo material të pësuar, në shumë prej 1,059.00€.

Nga Urdhër Transferi GFK.nr. 1195/11, dt. 10.10.2011, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka urdhëruar që të dëmtuarve në aksidentin e komunikacionit V.S., F.S. dhe Z.S.,ti bëhet pagesa në shumë prej 1,059.00€, për dëmin material të pësuar në automjet.

Nga Pasqyra mbi Transferindt. 10.10.2011, gjykata vërtetoi faktin se paditësja i ka paguar të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit V.S., F.S. dhe Z.S., shumë prej 1,059.00€.

Gjykata konstaton se nga provat qe gjenden në shkresat e lëndës, i padituri ka shkaktuar aksidentin në fjalë, me automjetin e markës “Passat”, me targa ..., i cili në momentin e aksidentit nuk ka pasur sigurim.

Gjykata konstaton se nga provat e prezantuara vërtetoi këtë gjendje faktike:se më datën 17.07.2011, rreth orës 16:00, i padituri si drejtues i automjetit të markës “VW Passat”, me targa të regjistrimit ..., ka shkaktuar aksident trafiku në P.1, me ç’rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku ka goditur automjetin e markës “Audi” me targa ..., pronë e Z.S., e ky automjet nga inercioni e ka goditur automjetin e markës “Suzuki”, me targa ..., pronë e E.H. me ç’rast janë shkaktuar dëme materiale në automjete dhe lëndime trupore pasagjereve të automjetit B dhe C si dhe drejtuesve të tyre.

Pas aksidentit në fjalë, i dëmtuari në këtë aksident V.S., F.S. dhe Z.S., kanë parashtruar kërkesë për kompenzim dëmi material dhe jo material pran paditëses B.K.S. në P.1, ku me të njëjtën ka arritur ujdj jashtëgjyqësore. Nga provat e administruara u vërtetua fakti se paditësja ka urdhëruar që në emër të dëmtuarvetë bëhet pagesë e mjeteve në shumë prej 1,059.00 €, të lënduarve V.S., F.S. dhe Z.S në aksidentin e datës 17.07.2011 si dhe të njëjti janë kompenzuar.

Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i automjeteve të pasiguruara është e rregulluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me Rregullin 3, i datës 25 shtator 2008 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë të datës 25.06.2004.

Neni 4.6 Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, parasheh: *“Në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar sigurimin e detyruar të autopërgjegjësisë-, zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë”.*

*“Pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime”.*

Gjykata vlerësoi përgjigjen në padi të bërë nga i padituri, pretendimet fillestare për kontestim të bazës juridike të kërkesëpadsisë, por nga deklaratimet e paditëse në seancën përgatitore të datës 11.09.2018, në të cilën mori pjesë i padituri, ku paditësja sa i përket bazës juridike të kërkesëpadsisë theksoi se i padituri lidhur me aksidentin e datës 17.07.2011, për demet e shkaktuara të dëmtuarve F.A., A.C., A.T. dhe B.M., të cilët e paditura i ka kompenzuar, me të paditurin në lëndën C.nr.3323/12, dt. 05.12.2017 ka arritur marrëveshje gjyqësore, etë cilat nuk u kontestuan nga i padituri vërtetohet fakti se i njëjti për aksidentin në fjalë veq ka pranuar përgjegjësin, me qka nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë.

Mbi bazën e të lartcekurave paditësja ka parashtruar padi ndaj paditësit, me kërkesëpër rimbursimin eshumës prej 1,059.00€, për dëmin tani të mbuluar në procedurë jashtë gjyqësore ndaj të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit i shkaktuar nga i padituri dhe atë për kompenzimin e të dëmtuarve V.S., F.S. dhe Z.S shumë prej 1,059.00 €.Gjykata mbi bazën e të lartcekurave, aprovoikërkesëpadinë e paditësit, duke aprovuar shumën prej 1,059.00 €, në emër të dëmit material dhe jo material, pasi qe e njëjta u provua se është përmbushur në tërësi nga ana e paditëses ndaj të dëmtuarve.

Gjykata duke vërtetuar gjendjen e lartcekur faktike, obligoi të paditurin që paditëses t'ia paguajë shumën si në dispozitiv pika 1, në emër të rimbursimit të dëmit material së bashku me shpenzimet procedurale, ndërsa refuzoi kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shumës si në dispozitiv pika 2, në emër të rimbursimit të dëmit jo material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale është marr konform dispozitës së nenit 452 të LPK-së, gjë që ka të bëjë me taksën gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Nga arsyet e theksuara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
C.nr.66/13 të datës 11.10.2018

Gjyqtari,  
Bujar Dobërdolani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit Gjykatë së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.